# DËSHMI ARKIVI

**A-449837**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Në pritje të vendimit, njerëzit që formësuan luftën e Kosovës |
| ADRESA | `https://a2news.com/rajoni-bota/kosova/aktualitet/ne-pritje-te-vendimit-njerezit-qe-formesuan-luften-i1185209` |
| BURIMI | a2news.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 16:07:21 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 16:03:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `0db42086d83de6e22898a6b0e6244b32b93212d40647c651169800c44d40c7be` |
| TEKSTI | `ea1171de3a6e1b19895b3f01ee018e83983bff257de608308eb53e526629d149` |
| PAMJA | `e3ee4615892ce53a6e748e727dbaa06fca76dbdd98a4665bd8f2c1816074b8d2` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `86d20290a3463e38a4d4dcb64486fa10a9908f58dd196eb278d2a00e2f3ee9a3` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `6d78d2dc60f31cde5fa6ff278c9155b75ea76fff53014b2b93764708aa00c94f` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/86d20290a3463e38a4d4dcb64486fa10a9908f58dd196eb278d2a00e2f3ee9a3`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Në pritje të vendimit, njerëzit që formësuan luftën e Kosovës

Nga Rosalba Bejdo
16 Shtator 2026, 18:03 | Aktualitet

**Nga fronti i luftës, në majat e institucioneve të Kosovës, e më pas në qelitë e Hagës. Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi janë tre prej figurave që mishërojnë një pjesë të historisë së UÇK-së dhe të shtetit të Kosovës.**

*"Gjyqi i nisur në Hagë ndaj katër ish-drejtuesve të lartë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk është një gjyq kundër UÇK-së, por kundër individëve që akuzohen për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit."* Kjo ishte deklarata të cilën ushtruesi i detyrës së Prokurorit Special e nënvizoi në mënyrë të veçantë në nisjen e gjyqit në Gjykatën Speciale të Hagës më shumë se pesë vite më pare, kur filloi procesi kundër katër ish-krerëve të UÇK.

Katër ish-drejtuesit e UÇK-së akuzohen se nga marsi i vitit 1998 e deri në shtator 1999 kanë kryer krime lufte dhe krime kundër njerëzimit ndaj pakicave etnike – atyre serbe dhe rome – si dhe ndaj rivalëve të tyre politikë që nuk i kanë mbështetur gjatë luftës dhe në qeverinë e formuar pas çlirimit. Ata akuzohen për përndjekje, trajtim çnjerëzor, ndalim, vrasje, zhdukje personash etj. Një rol të rëndësishëm përveç, Hashim Thaçit, patën, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi. Secili prej tyre ka pasur një pozitë të vendimtare për fitoren e UÇK, çka tregohet edhe në të kaluarën e tyre.

Kadri Veseli, i njohur gjatë luftës me pseudonimin "Luli", ishte ndër bashkëthemeluesit e hershëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe anëtar i Shtabit të Përgjithshëm. Gjatë konfliktit të armatosur, ai udhëhoqi Shërbimin e Zbulim-Kundërzbulimit, të njohur si G-2 - një strukturë kyçe përgjegjëse për informacionet strategjike, sigurinë e brendshme dhe organizimin logjistik e operativ.

Pas vitit 1999, Veseli vazhdoi drejtimin e Shërbimit Informativ të Kosovës deri në shpërbërjen e tij në vitin 2008. Më pas i hyri zyrtarisht politikës duke iu bashkuar PDK-së, parti të cilën e mori në drejtim pas zgjedhjes së Hashim Thaçit si President. Veseli ka shërbyer gjithashtu si Kryetar i Kuvendit të Kosovës për dy mandate, nga viti 2014 deri në vitin 2019.

Aktiviteti i tij politik u ndërpre në nëntor të vitit 2020, kur pas konfirmimit të aktakuzës nga Gjykata Speciale, u transferua në qendrën e paraburgimit në Hagë.

Gjatë viteve të luftës 1998–1999, Jakup Krasniqi shërbeu si zëdhënës zyrtar i UÇK-së dhe anëtar i Shtabit të Përgjithshëm. Përmes daljeve publike, komunikatave dhe intervistave për mediat e huaja, ai u bë zëri dhe fytyra më e njohur e rezistencës, duke informuar opinionin vendas dhe ndërkombëtar për veprimet e ushtrisë. Pas çlirimit, Krasniqi mbajti poste administrative si Ministër i Rindërtimit dhe më pas Ministër i Shërbimeve Publike në Qeverinë e Përkohshme.

Për tetë vite me radhë, nga viti 2007 deri në 2014, ai drejtoi Kuvendin e Kosovës për dy

TË FUNDIT
Kapetanović: Kriminelët bashkëpunojnë pa deklarata, rajoni duhet të jetë po aq i shpejtë
Plagosje me armë zjarri në Durrës
Vendimi në Hagë, reagon AKB: Kosova rrezikon të paguajë edhe çmimin ekonomik
Dënimi i krerëve të UÇK-së në Hagë, reagon Marta Kos: Vendimet duhet të respektohen

MË TË VIZITUARAT
Tragjedi në Sudan, shembet miniera e arit, të paktën 60 të vdekur, dhjetëra t...
Vendimi në Hagë për ish-krerët e UÇK-së, DASH për A2 CNN: Mbështesim drejtësi...
Grenell: Kurti duhet ta shpërbëjë Gjykatës Speciale

LIVE UPDATES
Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë
LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore
Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

Për tetë vite me radhë, nga viti 2007 deri në 2014, ai drejtoi Kuvendin e Kosovës për dy mandate rresht. Më vonë u shkëput nga PDK-ja për të bashkëthemeluar Nismën Socialdemokrate, ku mori postin e Kryetarit të Këshillit Kombëtar.

Më 4 nëntor 2020, Krasniqi u arrestua nga Zyra e Prokurorit të Specializuar dhe u dërgua në Hagë, ku vazhdon të përballet me procesin gjyqësor. I njohur me pseudonimin "Dhjetëshi", Rexhep Selimi i përket bërthamës më të parë themeluese të UÇK-së që nga fillimi i viteve '90. Si anëtar i Shtabit të Përgjithshëm dhe Inspektor i Përgjithshëm i ushtrisë, ai luajti një rol të drejtpërdrejtë operativ në terren, duke koordinuar zonat operative dhe organizimin e furnizimit me armatim.

Në periudhën e menjëhershme pasluftës, Selimi shërbeu si Ministër i Rendit Publik në Qeverinë e Përkohshme. Më vonë i hyri jetës parlamentare duke iu bashkuar Lëvizjes Vetëvendosje. Al u zgjodh deputet për disa legjislatura dhe ushtroi funksionin e shefit të grupit parlamentar të kësaj partie. Njëlloj si bashkëluftëtarët e tij, Selimi udhëtoi drejt Hagës në nëntor të vitit 2020 pas konfirmimit të aktakuzës nga Dhomat e Specializuara, ku po mbron rrugëtimin e tij dhe të UÇK-së.

**(A2 Televizion)**


## A2 CNN Livestream

MUND TE LEXONI GJITHASHTU

Detajet e verdiktit për ish-krerët e UÇK-së: Çfarë konstatoi trupi gjykues?

Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, reagon Mbretëria e Bashkuar: Vendimi të mos përdoret për të ndezur tensione

Milorad Dodik kundër vendimi për Hashim Thaçin: Duhej dënuar për krime kundër njerëzimit

Pas tensioneve para godinës së EULEX, qytetarët protestojnë para qeverisë, hidhen gurë drejt godinës

Nga lufta në Hagë! Çlirimtari, politikani dhe i pandehuri, 3 jetët e Hashim Thaçit

Çfarë u provua dhe çfarë jo? Surroi: 9 pika për të kuptuar vendimin ndaj ish-krerëve të UÇK-së

## Latest Videos




Skandal dënimi në Hagë. Liderët e Kosovës të ulen URGJENT. Qeveri Uniteti e kontakt me SHBA




"Kur goditen ish-komandantët goditet lufta e UÇK, por dhe e ardhmja e Kosovës"

VIDEO
"BE duhet të reagojë, janë sponsor të kësaj gjykate, politik dhe financiar dhe vendosin mbylljen..."

"BE duhet të reagojë, janë sponsor të kësaj gjykate, politik dhe financiar dhe vendosin mbylljen..."




Protestuesi: Gjykata NA KALLI, e kaloi dënimin që Serbia dha përgjigjet Adem Jasharin



© 2023 A2 CNN / G2 Media shpk
All Rights Reserved.

Mundësuar nga Mediadesk

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.